



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 07 tetor 2019
Nr. Ref.:RK 1440/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI40/19

Parashtrues

Alije Shabani, Lulëzim Shabani, Luljeta Shabani dhe Kujtim Shabani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 394/2018, të 14 janarit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Alije Shabani, Lulëzim Shabani, Luljeta Shabani dhe Kujtim Shabani, nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 394/2018 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) të 14 janarit 2019, me të cilin ishte refuzuar si i pabazuar revizioni i parashtruesve të kërkesës kundër Aktvendimit (Ac. nr. 4451/17) të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) të 17 korrikut 2018, në lidhje me propozimin e parashtruesve të kërkesës për përsëritjen e procedurës kontestimore.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës, të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 8 mars 2019, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 18 mars 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Artë Rama-Hajrizi (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
7. Më 21 mars 2019, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 11 shtator 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesit e kërkesës parashtruan për herë të dytë kërkesë në Gjykatë në lidhje me rastin e tyre, duke kontestuar vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta.

Faktet në lidhje me kërkesën KI145/16 që ndërlidhen me procedurën kontestimore

10. Më 30 korrik 2008, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi në Gjykatën Komunale kundër M. E. S., F. B., K. B. M., V. B. B., F. B. M., F. B. dhe V. B. (në tekstin e mëtejshëm: të paditurit) duke kërkuar konfirmimin e pronësisë lidhur me pronën e trashëguar nga të paditurit, nga i ndjeri E. B., duke pretenduar se një pjesë nga pronat e trashëguara nga të paditurit i takonte të ndjerit I. Sh., paraardhës i parashtruesve të kërkesës.
11. Më 31 tetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore), përmes Aktgjykimit [C. nr. 1477/2008], refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesve të kërkesës.
12. Parashtruesit e kërkesës u ankuan kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [C. nr. 1477/2008] në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
13. Më 28 qershor 2016, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1219/2015], e refuzoi ankesën e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar.
14. Parashtruesit e kërkesës parashtruan revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 1219/2015] për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
15. Më 9 nëntor 2016, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 263/2016], e refuzoi revizionin e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar.
16. Më 12 dhjetor 2016, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën KI145/16 në Gjykatë duke kërkuar vlerësimin e kushtetushmërisë së Aktgjykimit [Rev. nr. 263/2016] të Gjykatës Supreme.
17. Më 8 maj 2017, Gjykata Kushtetuese nxori Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI145/19, duke deklaruar kërkesën e tyre si qartazi të pabazuar.

Faktet në lidhje me kërkesën e tanishme KI40/19, që ndërlidhen me propozimin për përsëritje të procedurës

18. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë në Gjykatën Themelore për përsëritjen e procedurës kontestimore (objekt shqyrtimi në rastin KI145/16), duke pretenduar, mes tjerash, se dëshmia e dëshmitares L.V. në bazë të së cilës janë bazuar vendimet e gjykatave të rregullta në procedurën kontestimore ishte e rrejshme, dhe se me këtë rast ishin plotësuar kushtet për përsëritjen e procedurës.
19. Më 5 korrik 2017, Gjykata e Apelit, duke vendosur në instancë të parë, përmes Aktvendimit [CN. nr. 72/2017], refuzoi si të pabazuar propozimin e parashtruesve të kërkesës për përsëritjen e procedurës, si të pabazuar duke arsyetuar, mes tjerash, se nuk ka prova se vendimet e gjykatave në procedurë

kontestimore, janë marrë si pasojë e veprave penale të kryera nga dëshmitarë, apo mbi bazën e dokumentacionit të falsifikuar ose të verifikuar me përmbajtje të pasaktë, pasi që nuk është zhvilluar asnjë procedurë penale në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me dëshminë e dëshmitares L. V. Mbi këtë bazë, Gjykata e Apelit kishte vendosur se nuk ishin plotësuar kushtet ligjore për të lejuar përsëritjen e procedurës në lidhje me rastin e parashtruesve të kërkesës.

20. Parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë ndaj Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [CN. nr. 72/2017], për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
21. Më 17 korrik 2018, Gjykata e Apelit, duke vendosur në instancë të dytë, përmes Aktvendimit [Ac. nr. 4451/17] refuzoi ankesën e parashtruesve të kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [CN. nr. 72/2017].
22. Parashtruesit e kërkesës parashtruan revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 4451/17] për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
23. Të paditurit parashtruan përgjigje ndaj revizionit, me propozim që Gjykata Supreme ta refuzojë revizionin e parashtruesve të kërkesës.
24. Më 14 janar 2019, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 394/2018] e refuzoi revizionin e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 4451/17], të 17 korrikut 2018.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me vendimin e kontestuar, Gjykata Supreme ka bërë shkelje të të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, dhe si rezultat i kësaj edhe të të drejtës për mbrojtje të pronës të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës.
26. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se edhe pse ata kanë arsyetuar faktin që dëshmitarja L.V. është në raporte familjare me të paditurit, dhe ka dhënë deklaratë të rreme, ky fakt nuk është marrë parasysh nga gjykatat e rregullta kur ato kanë vendosur për propozimin e tyre për përsëritje të procedurës.
27. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 394/2018, nuk është fare i arsyetuar, përderisa theksojnë që neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përcaktojnë që vendimet gjyqësore të arsyetuara janë kërkesë imperative për një gjykim të drejtë.
28. Parashtruesit e kërkesës përsërisin disa nga pretendimet e paraqitura në kërkesën KI145/16 duke pohuar se Gjykata Supreme nuk mori parasysh se të paditurit, si trashëgimtarë ligjorë të të ndjerit E. B., pa dijeninë e paraardhësit të parashtruesve të kërkesës I. Sh., kanë zhvilluar procedurën e trashëgimisë,

duke mos e paraqitur si trashëgimtar I. SH., i cili është djali i tani të ndjerit E. B. dhe ka qenë në jetë në kohën e shqyrtimit të trashëgimisë. Të paditurit, duke mos e përfshirë paraardhësin e paditësve si trashëgimtar ligjor në aktvdekje kanë bërë vepër penale, duke shkelur ligjin për trashëgiminë në dëm të parashtruesve të kërkesës.

29. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të konstatojë se e drejta e tyre për një gjykim të drejtë dhe e drejta për mbrojtje të pronës janë shkelur nga gjykatat e rregullta, si dhe të anulojë Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 394/18, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 4451/17 dhe Aktvendimin C. nr. 72/2017.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
31. Gjykata rikujton se parashtruesit kanë parashtruar dy kërkesa në Gjykatën Kushtetuese. Kërkesa e parë, që kishte të bënte me procedurën kontestimore të parashtruesve të kërkesës ishte deklaruar nga Gjykata si qartazi e pabazuar përmes Aktvendimit për papranueshmëri në rastin KI145/19.
32. Në kërkesën e tanishme KI40/19, parashtruesit e kërkesës kontestojnë para Gjykatës vendimet e gjykatave të rregullta që ndërlidhet me propozimin e tyre për përsëritjen e procedurës që kanë përfunduar me Aktvendimin [Rev. nr. 394/2018] e Gjykatës Supreme. Rrjedhimisht, Gjykata do të kufizohet vetëm në vlerësimin e vendimeve të gjykatave të rregullta që ndërlidhen me përsëritjen e procedurës, pasi që kjo është objekt i çështjes së kërkesës KI40/19.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

34. Gjykata i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

35. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]”

36. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar të cilët kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Rev. nr. 394/2018] e 14 janarit 2019 të Gjykatës Supreme, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu i kanë sqaruar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

37. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 3 (b) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që parasheh:

“(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;

[...]”

38. Gjykata gjithashtu përsërit se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

39. Sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtës së tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të saj, përsërit se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohen në kërkesat për të rihapur apo përsëritur procedurën (shih, në mënyrë analoge, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI80/15, KI81/15 dhe KI82/15, parashtrues *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2016, paragrafi 31; shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-se, *inter alia*, *Oberschlick kundër Austrisë*, nr. 23727/94, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 marsit 1994, *Dowsett kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8559/08, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 janarit 2011, *Sablon kundër Belgjikës*, nr. 36445/97, Aktgjykim i 10 prillit 2001, paragrafi 86).

40. Prandaj, Gjykata konsideron se neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së, nuk zbatohet në propozimin e parashtruesit për përsëritje të procedurës (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese: KI80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 32).

41. Gjykata thekson se pajtueshmëria *ratione materiae* e kërkesës me Kushtetutën rrjedh nga juridiksioni material i Gjykatës. E drejta në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës duhet të mbrohet me Kushtetutë, në mënyrë që një ankesë kushtetuese të jetë në pajtim *ratione materiae* me Kushtetutën. Megjithatë, Kushtetuta nuk i garanton parashtruesit të kërkesës të drejtën për rishikim dhe përsëritje të procedurës (shih, në mënyrë analoge, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 33 dhe KI07/17/15, *Pashk Mirashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 qershorit 2017, paragrafi 66;).
42. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesve të kërkesës lidhur me refuzimin nga gjykatat e rregullta për të përsëritur procedurën nuk është *ratione materiae* në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
43. Sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, e drejta për mbrojtje të pronës është shkelur si rezultat i shkeljeve të së drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Duke pasur parasysh se në lidhje me kërkesën e parashtruesve, neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk aplikohen lidhur me propozimin për përsëritjen e procedurës, Gjykata nuk do të vlerësojë shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës.
44. Për këtë arsye, Gjykata më tej konsideron se kërkesa e parashtruesve nuk i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri siç përcaktohet me Kushtetutë dhe siç parashihet më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës, andaj duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës, më 11 shtator 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- I. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- II. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi